

VENDIM
Nr. 42, datë 4.8.2016

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT TË MBETUR, PËR DISA PROJEKTE ME CIKËL
2014–2015, TË GRANTIT “INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE”,
PROGRAMI I ZHVILLIMIT VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I,
PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të mbetur, për disa projekte me cikël financimi 2014–2015, për grantin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, për vitin 2016, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR

Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.

Tabela 1

LISTA E PROJEKTEVE ME CIKËL FINANCIMI 2014–2015, QË FINANCOHEN
NGA GRANTI I INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, PROGRAMI I
ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I,
FINANCIMI PËR VITIN 2016

N r.	Autoritet i kontraktues	Emërtimi i projektit	Nr. i vendimit/eve të KZHR-së	Vlera e projektit (në lekë)	Vlera e kontratave (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2014 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016 (në lekë)
QARKU FIER									
1	Bashkia Divjakë	Shëtitorja Divjakë –Pishaj	nr. 2, datë 9.4.2014, nr. 7, datë 10.06.2014	46,000,000	45,685,716	34,800,000	5,065,716	-	5,820,000
AGJENCI ZHVILLIMI									
2	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Studime dhe projektet për projekte të FSHZH-së	nr. 12, datë 1.8.2014, nr. 18 datë 19.11.2014, nr. 39 datë 16.10.2015	350,000,000	350,000,000	20,000,000	110,000,000	162,510,062	57,489,938
TOTALI				396,000,000	395,685,716	54,800,000	115,065,716	162,510,062	63,309,938

Shënim.

1. “Vlera e projektit” përfaqëson vlerën e projektit të miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. “Vlera e kontratave” përfaqëson vlerën e kontraktuar, në kontratat përkatëse, nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve/shërbimeve të projektit dhe “korrekton” vlerën e projektit. Vlera e kontratave vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).

3. “Vlera e financimit për vitin 2014” tregon vlerën e alokuar për vitin 2014, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

4. “Vlera e financimit për vitin 2015” tregon vlerën e alokuar për vitin 2015, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

5. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e alokuar për vitin 2016, deri më tani, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

6. “Vlera e mbetur e financimit për vitin 2016” tregon diferencën midis vlerës së kontratës dhe atë të financimit për vitin 2014, 2015 dhe 2016, dhënë deri tani, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Propozimi për financimin e kësaj vlere vjen nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban), me shkresën 3738 prot., datë 1.7.2016.